

VENDIM
Nr.925, datë 21.12.2016

**PËR SHPËRNDARJEN DHE DETAJIMIN E FONDIT TË INVESTIMEVE PËR
FUNKSIONIN E RRUGËVE RURALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të aktit normativ nr.2, datë 16.12.2016, “Për disa ndryshime në ligjin nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi për investime për funksionin e rrugëve rurale, miratuar me aktin normativ nr.2, në shumën 1 999 217 537 (një miliardë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekë, ndahet ndërmjet bashkive, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond u akordohet bashkive dhe do të përdoret për financimin e projekteve për rrugët rurale.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Tabela 1: Shpërndarja e fondit të investimeve për funksionin e rrugëve rurale sipas projekteve

Qarku	Bashkia	Projekti	Vlera (në lekë)
BERAT	Bashkia Ura Vajguore	Sistemim I rruges se tregjeve (loti 1)	70,939,476
	Bashkia Skrapar	Rikonstruksioni I rruges Alish Grecka	31,356,441
DIBER	Bashkia Diber	Rikonstruksion I rruges se Dovolanit	45,624,844
DURRES	Bashkia Durres	Rikonstruksion rruga fshatin "Bozanhie", rruga e "Muçve", rruga "Qender Rromanat", ne Rrashbull	24,996,204
	Bashkia Shijak	Rehabilitimi i hapesirave dhe rikonstruksion i rruges tek lagjia Kokomaneve, fshati Ardhisht	97,067,954
ELBASAN	Bashkia Belsh	Ndertim sistemim asfaltim rruga Trojas	73,219,418
	Bashkia Gramsh	Rikonstruksion I rruges automobilistike nga fshati Shemrize deri te deri te ura Skenderbegas (lot 1)	86,108,257
	Bashkia Librazhd	Ndertim Rruga Orenje- Librazhd (Loti 2)	131,313,000
FIER	Bashkia Fier	Rikonstruksion I rruges Qender - Cakran - Autostrade	47,132,234
GJIROKASTER	Bashkia Libohovë	Rikonstruksion i rruges kthesa- ura e suhes (lot 1)	70,275,700
	Bashkia Gjirokaster	Rruga Dhoksat - Qestorat	74,684,315
	Bashkia Tepelene	Sistemim-asfaltim Rruga "Dragot-Pasarele" (lot 1)	60,219,880
	Bashkia Kelcyre	Rruga Suk Zhepove (loti 1)	75,000,000
	Bashkia Permet	Projekti i ndërtimit të urës së re dhe rikonstruksioni i rrugës për në fshatin Pëllumbar	48,460,372
KORCE	Bashkia Korce	Rikonstruksioni i rrugëve rurale dhe informale	71,230,000
	Bashkia Kolonje	Rruga hyrëse ne fshatin Selenicë, Starje dhe Tac Lart	95,044,839
	Bashkia Pustec	Rikonstruksion Sistemim Asfaltim Rruga Korce - Gorice Gollomboc	27,484,572
LEZHE	Bashkia Kurbin	Projekti per rrugen Shullaz Fushe	60,000,221
	Bashkia Lezhe	Rikonstruksion i rruges superstrate IEPV Shenkoll	41,000,000
	Bashkia Mirdite	Rruga Klos Dogjon	100,000,000
SHKODER	Bashkia Vau i Dejes	Rruga Deje - Qender	50,522,126
	Bashkia Malesi e Madhe	Sistemim Asfaltim Aksi Rugor Bajze-Rrethrotullim" Njeisa adm. Kastrat	67,419,879
	Fushe Arres	Rruga fush e zi	59,294,430
	Bashkia Pukë	Rikonstruksion rruga Auro Lumzi	41,513,809
TIRANE	Bashkia Kavaje	Rikonstruksion i rruges Mandarinat	61,231,315
VLORE	Bashkia Sarande	Rikonstruksioni dhe shtimi I rruges bujqesore te fushes se Palit	95,000,000
	Selenice	Rruga Peshepi Treblove (lot 1)	46,865,000
	Bashkia Vlore	Rikonstruksioni I rruges "ura tek varrezat - Risili"	115,067,820
	Bashkia Finiq	Rruga Fitore Aliko	70,878,387
	Bashkia Konispol	Rehabilitimi I unazes ekonomike (loti 1) shkalle Mursi	60,267,044
TOTAL			1,999,217,537